



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

Drejtoria e Integritit dhe Projekteve

**OFROHET BURSË PËR STUDIME UNIVERSITARE NË FEDERATËN RUSE PËR  
VITIN AKADEMIK 2014-2015**

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Rusinë në fushën e arsimit, Instituti i mirënjohur Shtetëror i Moskës për Marrëdhënie Ndërkombëtare (Moscow State Institute of International Relations, MGIMO-University) ofron për shtetas shqiptarë 1 (një) të dejtë studimi me bursë për studime universitare (Bachelor) për vitin akademik 2014-2015.

Kandidatët e interesuar për ndjekjen e studimeve universitare duhet të përgatisin listën e dokumenteve në vijim:

1. Kërkesën për studime, duke specifikuar degën në të cilën kandidati dëshiron të studiojë. Në kërkesë të jepet një adresë kontakti e-maili dhe numër telefoni;
2. Vërtetimin e notave për dy vitet e para dhe të semestrit të parë të vitit të tretë të shkollës së mesme ose diplomën e shkollës së mesme. Këto dokumente duhet të jenë të firmosura nga Drejtoria ose Zyra Arsimore e rrethit përkatës;
3. Fotokopjen e faqes së të dhënave të pasaportës;
4. Raportin mjekësor për aftësi studimi;
5. Vërtetim mjekësor ose grafi rendgen (flurografi) të krahavorit;
6. Raportin mjekësor për sëmundjet: difteri, tuberkuloz, tetanos, fruth, sifilizi;
7. Certifikatën ndërkombëtare mbi analizat për virusin SIDA;
8. 12 fotografi 3X4 (bardhë e zi);
9. Kandidati duhet të pajiset edhe me policën e sigurimit shëndetësor, e marrë në territorin e Federatës Ruse.

Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit pranë Drejtorisë së Integritit dhe Projekteve në MAS është data **16 qershor 2014**.

Ndër kushtet e ofruara nga pala ruse është njohja shume e mirë e gjuhës ruse në nivelin e mësim marrjes nga Universiteti. Nëse kandidati do të ndjekë fakultetin e Marrëdhënieve Ekonomike Ndërkombëtare, duhet të zotërojë ciklin e disiplinës së matematikës. MGIMO njofton se kandidati i përzgjedhur duhet t'i nënshtrohet testimit të gjuhës ruse që bëhet më datë **27 qershor 2014** në mjediset e këtij instituti.

Lidhur me kushtet e akomodimit, studentët duhet të bëjë kontratë banimi për në konvikt, i cili duhet të paguhet nga 6 deri në 12 muaj përpara.

Nënvizojmë se dokumentet e kandidatëve duhet të jenë të plota sipas listës së mësipërme, të noterizuara dhe të përkthyer në gjuhën ruse, si dhe të konfirmuara në Ambasadën Ruse në Tiranë.

Kandidati merr përsipër shpenzimet për organizimin e pritjes së tij, për udhëtimin deri në vendin e studimit (duke filluar nga 250 USD e me shume) dhe për siguracionin shëndetësor në Federatën Ruse (duke filluar nga 250 USD në vit).

Në përputhje me rregullat e legjislacionit rus të emigracionit, ardhja e kandidatit në Rusi duhet të realizohet jo më vonë se 20 ditë kalendarike para skadimit të vizës hyrëse për qëllime mësimi.

## **DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE**